

**URDHËR**  
**Nr. 50, datë 1.2.2024**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”; në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; në VKM-në nr. 870, datë 14.12.2021, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencës së ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon:

a) realizimin e procedurave të prokurimit publik me fonde buxhetore të institucionit;

b) dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km, si dhe me shërbim jashtë vendit;

c) nënshkrimin e kontratave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 14, datë 16.1.2023, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**  
**Igli Hasani**